



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Tema:

“Zhvillimi i arsimit shqip në Vushtrri gjatë viteve 1974 - 1991”

Mentori:

Prof. Dr. Muhamet Qerimi

Kandidati

AGRON MUSTAFA

Prishtinë, qershor 2022

Rezyme

Temën e masterit është e ndarë në tre kapituj që të kuptohet e të punohet më lehtë dhe më mirë. Partia Komuniste e Jugosllavisë, ndaj shqiptarëve bëri padrejtësi qysh nga Konferenca e Bujanit, ku vendimet e saj i shpalli të pa zbatueshme në Kosovë. Vendimet e Konferencës së Bujanit u anuluan menjëherë pas përfundimit të Luftës Nacional Çlirimtare në Kuvendin e Prizrenit. Kuvendi i Prizrenit, që u mbajt me 8-10 korrik 1945, mori vendim që Kosova të aneksohej nga Serbia dhe Jugosllavia. Shqiptarët që mbeten në kuadër të Jugosllavisë asnjëherë nuk u pajtuan me statusin e tyre, por u angazhuan vazhdimisht për ta ndryshuar në të mirë gjendjen e tyre. Gjatë vitit 1968, studentet organizuan demonstrata në Prishtinë duke kërkuar avancim të statusit të autonomisë për Kosovën. Po në të njëjtin vit në shumë komuna të Kosovës u organizuan diskutime publike për ndryshimin e statusit që Kosova të barazohet me njësit tjera të Federatës Jugosllave. Në vitin 1971 në Kuvendin Federativ u miratuan projekt-amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës së Jugosllavisë. Me këto projekt-amendamente me 28 shkurt të vitit 1974 u aprovua Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Kushtetuta e vitit 1974 ishte „Kushtetuta e parë e Kosovës”. Me këtë avancim kushtetues, Kosova fitoj funksionin e njëjtë në shumë fusha sikur edhe republikat e tjera të ish-Jugosllavisë, vetë e rregullonte pushtetin, e aprovonte Kushtetutën, aprovonte ligjet e veta, planin e përgjithshëm, buxhetin. Kosova tani kishte të drejtën e plotë të legjislaturës dhe jurispedencës për arsim, shkencë dhe kulturë. Ishte e pavaraur në rregullimin e të gjitha çështjeve të arsimit. Pas demonstratave të vitit 1981, statusi shoqëroro –politik juridik i shqiptarëve dhe i vetë Krahiës Autonome të Kosovës erdhi duke u minimizuar.

Slllobodan Millosheviqi sensibilizoi opinionin serb për kinse pozitën e disfavorshme kushtetuese, territoriale, ekonomike e shoqërore të Serbisë në Federatën Jugosllave. Ai e bëri këtë nëpër qindra mitingjeve të ashtuquajtura të solidaritetit me serbët e Kosovës. Duke parë shqiptarët rrezikun e heqjes së Kushtetutës së vitit 1974 , shqiptarët mitingjeve serbe ju kundërvunë me protesta dhe demonstrata për ta mbrojtur Kushtetutën e vitit 1974. Politika e udhëheqësve të Federatës Jugosllave, duke menduar se apetitet serbe do të kënaqen me heqjen e Kushtetutës së Kosovës, lëshuan pe dhe i dhanë përkrahje udhëheqjes serbe. Me këtë veprim të udhëheqjes

serbe dhe jugosllave nuk u pajtuan shqiptarët e Kosovës. Ata organizuan shumë protesta , demonstrata dhe greva kundër një veprimi të tillë. Ngjashëm sikur populli shqiptar, vepruan edhe deputetet shqiptar në Kuvendin e Kosovës , duke mos i miratuar ndryshimet kushtetuese, por ata në Kuvendin e Kosovës tentuan ta shpallin deklaratën e 2 korrikut 1990, por u larguan me forcë nga aty , por vullnetin e tyre ata e realizuan para Kuvendit të Kosovës në masa të rrepta të policisë u lexua deklarata e 2 korrikut të cilën e lexoi delegati nga Vushtrria Muharrem Shabani. Po këta delegat me 7 shtator 1990 , miratuan edhe Kushtetutën e Kosovës në Kaçanik.

Arsimi fillor

Zhvillimi i arsimit shqip në komunën e Vushtrrisë fillet e saj i ka që nga viti 1915, kur Kosova ishte e pushtuar nga Austro-Hungaria. Në vitin 1915 u hap shkolla e parë shqipe . Jetëgjatësia e shkollës shqipe në Vushtri ishte shumë e shkurtër. Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore Kosova u ripushtua nga shteti Serbo-Kroato-Slloven. Pushteti i ri i instaluar në Kosovë dhe në Vushtrrisë mori vendim që të gjitha shkollat shqipe të mbyllën. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, Kosova u pushtua nga nazi-fashizmi gjerman, italian dhe ai bullgar. Vushtrria i takoi zonës që ishte e pushtuar nga gjermanet. Pushteti i instaluar gjerman në Vushtri, nuk pengoi hapjen e shkollave shqipe. Hapjen e shkollave kombëtare shqipe në trojet etnike e mori përsipër Ministria e Arsimit e Mbretërisë Shqiptare në Tiranë . Ministri i Arsimit Ernest Koliqi me dekret të veçantë emëroi 300 mësues, gjithandej trojeve shqiptare. Në bazë të dekretit të Ministrit të Arsimit , me 12 qershor 1941, në Vushtri vijnë mësuesit Idriz Fishta i Gjirokastrës dhe Shaqir Hoti i Shkodrës. Gjatë këtyre viteve në komunën e Vushtrrisë u hapën shkollat në qytetin e Vushtrrisë dhe në fshatrat e saj: në Smrekonicë, Stanofc, Lumë të Madh, Maxhunaj, Pantinë, Bivolak, Studime dhe Breznicë. Unë besojë se bazat e arsimit shqip në Kosovë dhe trojet etnike shqiptare në ish-Jugosllavi janë vënë në vitet 1941-45. Me ripushtimin e Kosovës nga Jugosllavia komuniste shkollat shqipe nuk u mbyllën përkundrazi pushteti komunist për ta përfituar popullatën shqiptare, hapi në fillim në të gjitha fshatrat shkolla shqipe , por më vonë do të vije deri te zvogëlimi i shkollave shqipe . Në shumë fshatra shkollat shqipe do të mbyllën duke i bashkuar nxënësit e disa fshatra në një shkollë. Zhvillimi i arsimit shqip në komunën e Vushtrrisë nga viti 1974 deri në vitin 1991, pati një zhvillim të hovshëm. Këtë zhvillim të hovshëm e mundësoi aprovimi i Kushtetutës së vitit 1974. Zhvillimi i arsimit shqip në Kosovë si dhe në Vushtri gjatë vitit 1974 deri në vitin 1980 janë vitet më të arta të arsimit shqip .Që nga viti 1974 e deri në vitin 1991, i kam trajtuar për çdo periodë dhe për çdo vit të gjitha anët pozitive dhe negative si dhe me problemet dhe përpirësit që pati zhvillimi i arsimit në komunën e Vushtrrisë.

Organet kompetente të arsimit komunal së bashku me organet e shkollave fillore kanë bërë përpjekje maksimale që të përfshihen në shkollimin fillor të gjithë fëmijët e moshës 7 vjeçare. Me reformat e reja shkollore që u bënë në vitin 1975, në komunat e Kosovës si dhe në komunën e Vushtrrisë u formuan disa Bashkësi Vetëqeverisëse të Interesit. Në kuadër te bashkësive të interesit u formua edhe Bashkësia e Interesit për Arsim, e cila luajti një rol të rëndësishëm shumë të madhe në rritjen dhe zhvillimin e arsimit në komunën e Vushtrrisë. Bashkësia

Vetëqeverisëse për Arsim dhe Edukim ka kontribuar pozitivisht në koordinim, sinkronizimin dhe harmonizimin e shumë proceseve që mundësojnë një zhvillim më të shpejt të arsimit. BVI në Komunën e Vushtrrisë ka kontribuar në shumë aspekte. BVI për Arsim ka bërë përpjekje maksimale në për përmisimin e kushteve për mësim duke pajisur shkollat me mjete të konkretizimit, me hapjen e kabineteve dhe laboratorëve, në dhënien e teksteve shkollore për nxënësit e varfër falas, në ndarjen e bursave dhe kredive për nxënës dhe student, në ndërtimin e shumë objekteve shkollore si dhe në përmirsimin e bazës materiale të arsimtarëve. Gjatë kësaj periode arsimit në komunën e Vushtrrisë pasoi një rritje në numrin e nxënësve prej vitit në vit. Organet arsimore në komunën e Vushtrrisë kanë arritur të përfshijnë në shkollat fillore në klasën e parë rreth 97% të nxënësve kure në klasën e tetë kjo përqindje ishte më e vogël në 92 %. Arsyeja e mospërfshirjes të të gjithë nxënësve në ciklin e lartë të shkollave fillore ishte se shumë prindër pengonin vajzat e tyre për të vazhduar shkollimin .Organet e shkollës dhe ato komunale të arsimit kanë marrë masa administrative ndaj këtyre prindërve duke paraqit fletëparaqitje në organet gjyqësore. Pati një rritje edhe në ndërtimin e shumë objekteve shkollore. Në vitin shkollor 1975/76, në komunën e Vushtrrisë kanë qenë 15 shkolla të plota fillore dhe 17 paralele të ndara fizike, ndërsa në vitin shkollor 1989/90 në komunën e Vushtrrisë kanë qenë 19 shkolla të plota fillore dhe 11 paralele të ndara fizike . Numri i nxënësve në vitin shkollor 1975/76 ishte 12078 nxënës , ndërsa në vitin shkollor 1989/90, ky numër ishte 16906 nxënës, për 4828 nxënës më shumë. BVI të Arsimit ka bërë përpjekje maksimale në kualifikimin e kuadrit mësimor për shkollat fillore. Për këtë qëllim BVI e Arsimit gjatë këtyre viteve ka ndarë bursa dhe kredi për studentë që kanë studiuar në SHLP dhe fakultete në Universitetin e Prishtinës për një numër të madh e me theks të veçantë për lëndët deficitare. Problemi me kuadër, shkollat në komunën e Vushtrrisë e ka përcjellë gjatë gjithë kohës. Në ciklin e ultë mësimor , kuadri shkollor ka arrit të jetë i tëri i kualifikuar. Në shumë tabela kemi dhënë gati për çdo vit suksesin e nxënësve në shkollat fillore të komunës së Vushtrrisë. Gjithashtu kemi paraqit tabela për të parë më mirë kuadrin nëpër vite shkollore, kemi dhe në hapësirat e përdorur gjatë punës me nxënës në shkollat e komunës . Sa i përket objekteve shkollore edhe pse janë ndërtuar shumë shkolla të reja në qytet si dhe në fshatrat e komunës, megjithatë asnjëherë nuk është plotësuar nevoja e hapsires , sepse në çdo vit në tërë komunën e Vushtrrisë rritej numri i nxënësve nga 276 deri në 356 nxënës në vit. Për kundër vështërsive që u përmendën deri me tani sukcesi i nxënësve nuk ka munguar por ka qenë shumë i mirë.

Shkolla e mesme në komunën e Vushtrrisë

Deri në vitin shkollor 1951/52, në komunën e Vushtrrisë nuk ka funksionuar as një shkollë e mesme . Në vitin shkollor 1951/52 është hapur Shkolla e Mesme e Nxënësve në Ekonomi në gjuhën shqipe. Për fatin e keq kjo shkollë mbyllët në vitin shkollor 1957/58 nga pushteti komunist. Shkolla e Mesme Ekonomike u ri hap në vitin shkollor 1961/62. Në vitin shkollor 1963/64, u hapën disa paralele të gjimnazit. Në vitin shkollor 1967/68 pranë gjimnazit u hapën paralele të shkollës për punëtorë të kualifikuar, kjo shkollë në vitin shkollor 1972/73, pavarësohet nga gjimnazi. Në fillimin e zbatimit të reformave në arsimin e mesëm në Kosovë në

vitin shkollor 1975/76 shkollat e mesme në Vushtrri përsëri do të bashkohen në një shkollë e cila do të quhej Qendre e Arsimit të Mesëm të Orientuar "Muharrem Bekteshi". Me rastin e këtij bashkimi , bëhet edhe ndërrimi i ndërtesave në të cilat do të zhvillohej mësimi i kësaj vatre arsimore. Nxënësit dy vitet e para i ndiqnin mësimet në lëndët e përgjithshme kurse nga viti i tretë orientoheshin në shkollat profesionale. Në komunën e Vushtrrisë nxënësit pas përfundimit të mësimi dy vjeçar ata kishin mundësitë të vazhdonin mësimet në këto seksione dhe drejtime . Nxënësit kishin mundësi të vazhdonin mësimet në gjimnazin natyror dhe atë shoqërorë, në drejtimin axhustator, kimi, tekstili dhe tregti. Në vitin shkollor 1976/77, në Qendrën shkollore kanë qenë të regjistruar sipas shkollave, seksioneve –drejtimeve , klasave dhe gjuhëve mësimore ishin; Mësimi i orientuar 19 paralel me 607 nxënës, Gjimnazi 21 paralele me 558 nxënës, axhustator 5 paralele me 100 nxënës, kimi 7 paralele me 234 nxënës, tekstili 7 paralele me 191 nxënës, tregtia me 1 paralele me 41 nxënës .

Sipas kësaj që u tha në vitin shkollor 1976/77 në Qendrën Shkollore ishin gjithsej të regjistruar 60 paralel me 1761 nxënës. Në vitin shkollor 1977/78, në Qendrën Shkollore "M. Bekteshi" ishin 67 paralele me 2155 nxënës, Në vitin shkollor 1978/79 në shkollën e mesme 65 paralele. Duke mos pasur hapsin të duhur në ndërresat e shkollave të mesme organet komunale të arsimit së bashku me organet e shkollës hapen disa paralele në Prelluzhë dhe Smrekonicë deri të ndërtohet aneksi i ri në shkollën e mesme. Hapja e paraleleve në këto shkolla u bë me të vetmin qëllim që në shkollat e mesme të përfshihen të gjithë nxënësit që e përfundojnë shkollën fillore. Numri i nxënësve të përfshirë në arsimin dhe edukimin e mesëm të orientuar përkatësisht pranë Qendrës shkollore "M Bekteshi" përkundër vështirësive materiale, mungueses së lokalit shkollor , të kuadrit të pamjaftueshëm e tjerë, prej vitit në vit ka shënuar trend të shtimit. Derisa në vitin 1980/81 gjithsej janë përfshirë 2459 nxënës , në 91 paralele në vitin shkollor vijues përfshirja shtohet në 3006 nxënës .Në qytetin e Vushtrrisë që nga viti shkollor 1971-1972 ishte hapur Shkolla e Mesme për Punë të Brendshme e cila në fillim ishte paralele e ndarë e shkollës së Kamenicës së Sremit në Serbi. Në vitin shkollor 1974/75, me vendim të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, SHMPB e Vushtrrisë ndahet nga shkolla e Kamenicës në Srem dhe pavarësohet si shkollë më vete. Sipas plan-programit , shkollimi i kadetëve zgjaste katër vite. Shkolla ishte e tipit konviktor. Kadetët që e kryenin shkollën e mesme për punë të brendshme gjatë kësaj kohe e kryenin edhe shërbimin ushtarak dhe provimin për shofer, kategoria "B" dhe u sigurohej puna në organet e punëve të brendshme të Kosovës. Shkolla punonte në kushte solide me lokal dhe kabinete të pajisur mirë. Kuadri arsimor në fillim është huazuar nga gjimnazi në Vushtrri dhe fakulteti juridik i Universitetit të Prishtinës. Më vonë u siguroa kuadri profesional për çdo lëndë në këtë shkollë.

Plan-programet shkollore në shkollat e komunës së Vushtrrisë ishin të njëjta me ato të komunave tjera në Kosovë. Në fillim në tërë Jugosllavinë u përdorën plan-programet e Mbretërisë Jugosllave, por ato shumë shpejt u ndërtuan me të reja. Në fillim kishim shkollimin fillor pesëvjeçar, pastaj shtatë vjeçar e më vonë tetë vjeçar. Planet dhe programet në shkollimin fillor u ndryshuan nga viti 1977 u aprovua ligji i ri për shkollat fillore. Po këtë vit filloi zbatimi i këtij

plan-programi të ri në klasat e para, dyta dhe klasa e pestë , vitin vijues në klasën e tretë dhe të gjashtë dhe në vitin 1978 në klasën e katërt , shtatë dhe tetë. Në vitin 1976 është bërë edhe programi i punës mbi Mësimin e Mesëm të Orientuar. Arsimi i Mesëm i orientuar ndahet në dy faza .Faza e parë përfshinë vitin e parë dhe të dytë të shkollës së mesme , ku edhe mësohen lëndët e përgjithshme mësimore. Faza e dytë përfshin klasën e tretë dhe katërt. Enti Komunal për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit në Vushtrri

Me rritjen e numrit të nxënësve dhe rrjetit shkollor u pa e nevojshme që të themelohet Enti komunal për përparimin dhe edukimin e arsimit në komunën e Vushtrrisë. Me vendimin e Kuvendit Komunal në Vushtrri në vitin 1982 u formua Enti Pedagogjik komunal. Formimi i tij pati rëndësi të madhe dhe ndikoj pozitivisht si të nxënësit ashtu edhe të arsimtarët në ngritjen e cilësisë në procesin mësimor.

Demonstratat e vitit 1981 së pari i filluan studentët e Universitetit të Prishtinës me 11 mars 1981.Si pretekës për fillimin e demonstratave ishte ushqimi i dobët në mensën e studentëve. Ndër faktorët kryesorë që ndikuan në shpërthimin e demonstratave të vitit 1981 në Kosovë janë; Pozita jo e barabartë e shqiptarëve në Federatën Jugosllave; Prapambetja ekonomike e Kosovës, në krahasim me vendet e tjera të RSFJ-së; Cenzura politike që ndiqej kundër shqiptarëve në shtetin Jugosllavë; "varësia" e Kosovës nga Serbia, që është përcaktuar në bazë të Kushtetutës së vitit 1974. Demonstratat e studentëve vazhduan me 25 mars në Prizren, me 26 dhe 31 mars në Prishtinë, me 30 mars në Obiliq. Demonstratat më masive u mbajtën me 1,2 dhe 3 prill 1981, në Prishtinë, Podujevë, dhe Vushtrri. Parullat kryesore të demonstruesve në Vushtrri ishin; Republikë-Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë ! , Poshtë familjarizmi!, Liri-Demokraci!, Trepça është e jona" etj. Udhëheqësit jugosllavë i shpallën demonstratat " kundërrevolucionare", nacionaliste, separatistë etj. U ndërморën aksione për zbulimin e organizatorëve të demonstratave. Demonstratat gjithëpopullore ishin shkas i mirë i pushtetit për të marrë masa ndaj rinisë dhe popullit shqiptarë në përgjithësi. Gjatë kohës se demonstratave u rrahën , u burgosën dhe u vranë shumë të rinjë shqiptarë. Pasoja të rënda përjetoi arsimi shqip. Shumë profesor, arsimtarë , mësues dhe nxënës u larguan nga puna u diferencuan, nxënës dhe student u larguan nga shkollim. Një ndër ngjarjet më të dhimbshme, që ka shënuar kthesë të rëndësishme në rrjedhat e kohës në Kosovë , është edhe helmimi i nxënësve shqiptarë nga pushteti serbë në pranverë të vitit 1990. Helmimi i nxënësve në shkollat shqipe në Vushtrri në mënyrë të pa ndërprerë zgjati prej 22 deri me 27 mars të vitit 1990. Në këtë rast u helmuan nxënësit e shkollave fillore dhe ata të shkollave të mesme prej moshës 7 deri 18 vjeç. Në shkollat e komunës së Vushtrrisë në të gjitha shkollat u helmuan 264 nxënës. Në shkollat e Vushtrrisë dhe në Kosovë ndodhi edhe një ngjarje e pazakont deri me tani segregacioni. Në vitin 1988, në shkollën fillore " Vuk Karaxhiq" të Prelluzhës u bë segregacioni për herë të parë i nxënësve në arsimin Kosovar i cili pastaj në vitet vijuese do të marrë përmasa shqetsuese. Me 8 tetor 1988 të gjithë nxënësit shqiptar largohem me dhunë nga objekti i tyre shkollor .

Tabela e numrit të paraleleve dhe i nxënësve në shkollat fillore të komunës së Vushtrrisë gjatë viteve 1975—1990.

Nr.	Viti shkollor	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1	1975/76	403	12078
2	1976/77	421	12617
3	1977/78	411	12327
4	1978/79	405	12142
5	1979/80	449	13463
6	1980/81	458	13738
7	1981/82	480	14380
8	1982/83	493	14776
9	1983/84	523	15683
10	1984/85	528	15786
11	1985/86	515	15464
12	1986/87	528	15848
13	1987/88	539	16164
14	1988/89	551	16515
15	1989/90	564	16906
16	1990/91	508	15243
